

## 2. Grupimi i të drejtave të fëmijëve në katër dimensione

Konventa për të Drejtat e Fëmijës mund të ndahet në katër grupime të të drejtave. Këto kategori mund të përdoren në veprimtaritë mësimore, duke u lejuar nxënësve përpjekjet për t'i grupuar të drejtat në katër kategori. Kjo mund të bëhet individualisht ose në grupe,

**I. Të luajmë një rol** – do të thotë të jesh i aftë të marrësh pjesë në proceset e vendimmarrjes, liria për të formuar grupe, liria e mendimit dhe liria për të fituar informacion nga burime të ndryshme.

**II. Të arrijmë potencialin tonë** – do të thotë se duhet të përmbushen kushte të veçanta, në mënyrë që të arrihet zhvillimi i duhur personal. Në këtë grup bëjnë pjesë të drejtat që lidhen me arsimimin, familjen, kulturën dhe identitetin personal si pjesë të rëndësishme të jetës sonë.

**III. Të jetojmë mirë** – E drejta për mbijetesë përfshin nevojat tona bazë. Këto përfshinë ushqimin dhe mbrojtje, standardin e jetesës dhe shëndetin.

**IV. Të qenit i lirë nga dëmtimet** – do të thotë që të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes nga abuzimi, shpërfillja, shfrytëzimi ekonomik, tortura, trafiku dhe prostitucioni. Në listën e mëposhtme, të drejtat renditen në këto katër kategori:

Grupi	Neni	Titulli i shkurtuar
I. Të luajmë rolin tonë: E drejta për pjesëmarrje	Neni 3	Përparësia e nevojave të fëmijës në vendimet politike, juridike dhe legjislaton
	Neni 12	Liria e mendimit dhe e drejta për t'u dëgjuar për të gjitha çështjet vetjake
	Neni 13	Liria e shprehjes
	Neni 14	Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar
II. Të zhvillojmë potencialin tonë: e drejta për t'u zhvilluar	Neni 5	Respektimi i të drejtave të prindërve
	Neni 7	Emri dhe nënshtetësia
	Neni 8	Mbrojtja e identitetit të fëmijës
	Neni 10	Ribashkimi familjar
	Neni 21	Birësimi
III. Të jetojmë mirë: e drejta jonë për mbijetesë	Neni 6	Mbrojtja e mbijetesës dhe zhvillimit
	Neni 9	Parimi i mosndarjes nga prindërit
	Neni 18	Parimi i mosndarjes nga prindërit
	Neni 24	Përgjegjësia e prindërve dhe kujdestarëve
	Neni 26	Përgjegjësia e prindërve dhe kujdestarëve
	Neni 27	Mbrojtja e shëndetit dhe e të drejtës për kujdes shëndetësor
	Neni 31	Mbrojtja e shëndetit dhe e të drejtës për kujdes shëndetësor

IV. Liria nga lëndimi: e drejta jonë për mbrojtje	Neni 2	Mos diskriminimi
	Neni 11	Mbrojtja nga rrëmbimi
	Neni 19	Mbrojtja nga abuzimi
	Neni 20	Të rinjtë pa familje
	Neni 22	Fëmijët refugjatë
	Neni 25	Rishikimi i trajtimit ose i kujdesit
	Neni 32	Puna e fëmijëve
	Neni 33	Mbrojtja nga drogat narkotike
Neni 34	Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual	

Në tabelën e mësipërme, mungojnë katër të drejta. Ato nuk mund të renditen në një nga kategoritë, sepse ato përqendrohen kryesisht në përgjegjësitë e shtetit. Ato janë:

Neni 1	Përkufizimi i fëmijës
Neni 4	Zbatimi i të drejtave
Neni 41	Standardet kombëtare më të larta kanë përparësi
Neni 42	Detyrimi për të bërë të njohura të drejtat